



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.911/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Burim Gërguri nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, me seli në Obiliq, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.911/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Burim Gërguri nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, me seli në Obiliq.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Burim Gërguri nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, me seli në Obiliq, në të cilën kërkon rinumërimin e votave vetëm për kandidatët Iniciativa Qytetare për Obiliqin në të gjitha vendvotimet në Komunën e Obiliqit, pasi që kanë vërejtje sa i përket leximit të votave për kandidatët me vija, një ndryshim për çdo kandidatë, ku ndryshimi vërehet nga 10% deri në 30% të leximit të votave. Gjithashtu thekson se duke parë që afërsia mes kandidatëve fitues dhe atyre në pritje janë diferenca të vogla, kërkojnë rinumërimin e votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit Burim Gërguri nga Subjekti Politik Iniciativa Qytetare për Obiliqin, me seli në Obiliq, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i votave vetëm për kandidatët Iniciativa Qytetare për Obiliqin në të gjitha vendvotimet në Komunën e Obiliqit.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.911/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesuesja e Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.